

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Infotelecom - Albsolar 1" SHPK**

Sot, më datë 18.11.2021, ortaku i vetëm si më poshtë:

- 1. Shoqëria INFO-Telecom SHPK**, shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT K92402002P, me seli në adresën: Rruga "Faik Konica" nr. 1, Pallati Kuq perballe Fakultetit Ekonomik, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori dhe njëkohësisht ortaku i vetëm z. Marin Gjonaj, sipas Vendimit të Ortakut të vetëm datë 17.11.2021.

Vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, me përmbajtjen si më poshtë:

**NENI 1
DATA E THEMELIT**

Sot, më datë 18.11.2021, themeluesi vendosi të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **"Infotelecom - Albsolar 1" SHPK**.

**NENI 2
FORMA E SHOQËRISË**

Shoqëria **"Infotelecom - Albsolar 1" SHPK** do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

**NENI 3
EMËRTIMI**

Emri i plotë i shoqërisë është **"Infotelecom - Albsolar 1" SHPK**.

**NENI 4
SELIA**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: **Rruga "Faik Konica" nr. 1, Pallati Kuq perballe Fakultetit Ekonomik, Tiranë, Shqipëri.**



Me miratim te organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “**Infotelecom - Albsolar 1**” SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Veprimtari në fushën e prodhimit të energjisë elektrike të rinuvueshme, siç është prodhimi i energjisë nga burime fotovoltaike, ruajtja dhe tregëtimi i kesaj energjie brenda dhe jashtë vendit. Sipas legjislacionit në fuqi, shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet të konsideruar të dobishëm apo të nevojshëm, për arritjen e objektivave të saj, i cili lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000.00 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortaku i vetëm si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
INFO-Telecom SHPK	100 %	1	10.000 (Lekë)

Ky kapital përbëhet nga 1 (një) kuotë, e zotëruar nga ortaku i vetëm.

Kapitali themeltar i nënshkruar është paguar plotësisht nga ortaku i vetëm.

NENI 8 ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë “Infotelecom - Albsolar 1” SHPK do të jetë:

Z. Arben Margilaj, shtetas shqiptar, lindur më 19.08.1959 në Fier dhe banuese në Tiranë identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. personal F90819080R, email: _____.
Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**NENI 9
DISPOZITA E FUNDIT**

Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.
Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.
Autorizohet Administratori **Z. Arben Margilaj** për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESI

Shoqëria INFO-Telecom SHPK
Administratori
Marin Gjonaj

Marin Gjonaj
6/4

